

Informacione për vaksinat COVID në gjuhët e komunitetit

Dokumenti mund të përkthehet për t'iu përshtatur gjuhës së lexuesit.

- Unë quhem (emri) dhe jam një (rol i punës në grupin e komunitetit / vendi i punës në (Komuna / Qyteti)
- Vaksina është mënyra më e mirë për tu mbrojtur nga COVID-19. Nëse merrni COVID-19, vaksina zvogëlon shanset tuaja për të zhvilluar simptoma serioze ose kërcënuese për jetën.
- Vaksinat COVID-19 kanë kaluar të njëjtat kontrolle sigurie si çdo gjë tjetër, janë të sigurt dhe efektive dhe janë aprovuar për përdorim në MB. Ato nuk përmbajnë ndonjë produkt shtazor ose vezë. Ato janë testuar në dhjetëra mijëra njerëz me prejardhje të ndryshme, përfshirë komunitetet etnike me ngjyrë, aziatike dhe minoritetet (BAME).
- Në Skoci vaksinat COVID-19 janë falas për të gjithë. Nuk kërkohen kontrolle të emigracionit për tu vaksinuar ndaj COVID-19 dhe Shërbimi Shëndetësor Kombëtar i Skocisë nuk i kalon detajet e pacientit në zyrat qendrore me qëllim zbatimin e ligjit të emigracionit.
- Nuk ka nevojë të kontaktoni mjekun tuaj personal lokal ose Bordin Shëndetësor të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar për të lënë një takim - do të kontaktoheni me letra ose me telefon kur t'ju vijë radha për tu vaksinuar.
- Kur të merrni ftesën për tu vaksinuar, lutemi të paraqiteni. Sa më shpejt të vaksinohemi të gjithë, aq më shpejt mund të kthehemi të bëjmë gjërat që kemi humbur. Nëse keni nevojë për një përkthyes, ekziston mundësia t'ju jepet një i tillë duke kontaktuar Bordin tuaj Shëndetësor lokal të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar.
- Sikurse të gjitha vaksinat, ju mund të keni disa efekte anësore të zakonshme, por këto janë zakonisht të lehta dhe nuk duhet të zgjasin më shumë se disa ditë. Për shembull, ju mund të keni një krah të lënduar ku është bërë gjilpëra, një dhimbje koke, të ndjeheni të sëmurë, të lodhur ose me dhembje.
- Nuk ka asnjë provë që dëshmon se vaksinat COVID-19 do të ndikojnë në pjellorinë tuaj. Ju nuk keni nevojë të shmangni shtatzëninë pasi të keni marrë vaksinimin COVID-19.

- Mendohet se vaksinat COVID-19 nuk përbëjnë rrezik kur ushqeni me gji. Ekspertët kanë rekomanduar se vakcina COVID-19 mund t'u jepet grave që ushqejnë me gji. Nëse jeni duke ushqyer me gji, ose planifikoni të ushqeni me gji, mund të vazhdoni dhënien e gjirit pas vaksinimit. Sidoqoftë, ekziston një mungesë e të dhënave të sigurisë për përdorimin e vaksinave COVID-19 gjatë ushqyerjes me gji ose efektit të tyre në foshnjën që ushqehet me gji.
- Megjithëse vakcina do të zvogëlojë shanset tuaj për t'u sëmurë rëndë, gjithsesi ju mund të sëmureni me COVID-19 dhe ta përhapni atë. Pasi të keni bërë vaksinën tuaj, është e rëndësishme që të vazhdoni të ndiqni këshillat më të fundit të qeverisë.
- Përvishni mëngët, bëni vaksinën dhe ndani këtë informacion me miqtë, familjen dhe kolegët tuaj.
- Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me vaksinën COVID-19, vizitoni nhsinform.scot/covid19vaccine ose telefononi në linjën e ndihmës për vaksinat COVID-19 në 0800 030 8013 e cila është e disponueshme nga 8 e mëngjesit deri në 8 pasdite, 7 ditë në javë. Ekziston informacion i disponueshëm në formate dhe gjuhë të ndryshme në nhsinform.scot/covid19vaccineleaflets

